



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA SHKODËR
KËSHILLI BASHKIAK**



Adresa: Rr. 13 Dhjetori, Nr.1 Shkodër,

web: www.bashkiashkoder.gov.al,

e-mail: keshilibashkiak@bashkiashkoder.gov.al,

**V E N D I M
Nr. 26, datë 30.3.2017**

Për shfuqizim të Vendimit nr. 68, datë 28.12.2011 të këshillit bashkiak Shkodër dhe dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim "Klubit të Futbollit Vllaznia" sh.a të terrenit sportiv "Reshit Rusi"

Këshilli Bashkiak Shkodër, në mbledhjen e tij të datës 30.03.2017, me propozim të kryetarit të bashkisë, mbështetur në nenin 9 pika 1.2, nenin 54 shkronja "e", nenin 55 pika 4 të ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", neni 113 pika 1 e ligjit nr 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit nr 9376, datë 21.4.2005 "Për Sportin", të ndryshuar, ligjit nr 10296, datë 8.7.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrrollin", të ndryshuar, Udhëzimit nr 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar,

V E N D O S I :

1. Shfuqizimin e VKB nr. 68, datë 28.12.2011 "Për miratimin e tjetërsimit të pasurisë nr. 12/45, e ndodhur në zk 8593, me pronar Bashkia Shkodër, në favor të K.F. Vllaznia sh.a., pa ndryshim destinacioni"
2. Dhënien në përdorim pa kundërshtëpërblim të pasurisë nr. 12/45 në zonen kadastrale 8593. Vol 10 faqe 199 terreni sportiv "Reshit Rusi", pronë e Bashkisë Shkodër, "Klubit të Futbollit Vllaznia" sh.a.
3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Miratuar në datën 30.3.2017

Shpallur në datën 30.3.2017

Sekretar i këshillit

Suel Hadri



KRYETAR

Xhemal BUSHATI



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

Pr. 5313 dt. 19. 4. 2017
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr.402/1 Prot

Shkoder, me 14.04.2017

Lënda:Lidhur me vendimin nr. 26, datë 30.03.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër.

Drejtuar: Këshillit të Bashkisë Shkodër

Prefekti i Qarkut Shkodër në zbatim të kompetencave që i jep ligji nr.107/2016, dt 27.10.2016 "Për Prefektin", neni 8, germa a, ligjit nr. 139/2015, datë 17.12.2015, për "Vetëqeverisjen vendore", neni 8, pika 2, neni 9, pika 1/1.2, shkronjat "a" dhe "c", neni 54, shkronja "e", nenit 55, pikat 4; ligjit nr. 44/2015 "Kodi i procedurave administrative i Republikës së Shqipërisë", neni 113, ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 "Për Pronat e paluajtshme të shtetit" (i ndryshuar); ligjit nr. 9376, date 21.04.2005 "Per sportin", (i ndyshuar), neni 8, ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 "Për Transferimin e pronave të paluajtshme të shtetit në njësitë e qevqerisjes vendore" (i ndyshuar); analizoi vendimin nr.26, datë 30.03.2017 të Këshillit të Bashkisë Shkodër "Për shfuqizim te vendimit nr.68, date 28.12.2011 te keshillit bashkiak Shkoder dhe dhenien ne perdorim pa kundershperblim terren sportiv "Reshit Rusi" "Klubit te Futbollit Vllaznia" sh.a për shkak se nuk është zbatuar në atë periudhë (sipas relacionit nr.762/3 prot dt 9.03.2017 bashkëlidhur VKB)".

Pas shqyrtimit, Prefekti ju autorizon të procedoni, por sqarohet se të dhënat kontabël të këtij objekti nuk janë pjesë e VKB¹.

Me respekt,

P R E F E K T I



¹ Nuk janë përcaktuar